

AKT NORMATIV
Nr. 17, datë 22.4.2020

**PËR PËRJASHTIMIN E ZBATIMIT TË PROCEDURAVE DHE TË AFATEVE
PËR PËRGATITJEN E PROJEKTDOKUMENTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESEM PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Përfundimisht për vitin 2020, si pasojë e situatës epidemike të shkaktuar nga COVID-19, procedurat dhe afatet për përgatitjen e projektdokumentit të programit buxhetor afatmesëm për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të përcaktuara në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk zbatohen.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama